

RREGULLORE KURRIKULA DHE PROCEDURA E REGJISTRIMIT NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR TEK NEHEMIAH GATEWAY ALBANIA

2020 – xxxx NG TEAM

© Fondacioni Nehemiah Gateway Albania 2020

Versioni 12.10.2020

Përmbajtja

Neni 1 Informacion i përgjithshëm mbi ciklet.....	3
Neni 2 Baza ligjore.....	3
Neni 3 Ndryshimet në programet shkollore	3
Neni 4 Viti shkollor	3
Neni 5 Tarifat e shkolimit dhe tarifa të tjera.....	4
Neni 6 Cikli parashkollor	4
Neni 7 Pranimi në ciklin parashkollor	4
Neni 8 Kurrikula e arsimit bazë (arsimi fillor dhe arsimi i mesëm i ulët)	4
Neni 9 Arsimi fillor	5
Neni 10 Pranimi në arsimin fillor	5
Neni 11 Arsimi i mesëm i ulët.....	5
Neni 12 Pranimi në arsimin e mesëm të ulët	5
Neni 13 Kurrikula e arsimit të mesëm të lartë	6
Neni 14 Arsimi i mesëm i lartë.....	6
Neni 15 Procedurat për kurrikulën me zgjedhje në arsimin e mesëm të lartë.....	6
Neni 16 Pranimi në arsimin e mesëm të lartë.....	7
Neni 17 Funkzioni dhe detyrat kryesore të Komisionit të Pranimit.....	7
Neni 18 Përbërja dhe mbledhjet e Komisionit të Pranimit.....	7
Neni 19 Lëshimi i diplomave, suplementit dhe certifikatave të tjera	8
Neni 20 Transferimi i nxënësve	8
Neni 21 Veprimtarite plotësuese dhe jashtë kurrikulare	8
Neni 22 Oraret e mësimit	9
Neni 23 Veprimtaritë plotësuese dhe ato jashtëshkollore.....	9
Neni 24 Publikimi i rregullores	9
Neni 25 Hyrja në fuqi.....	10

Neni 1

Informacion i përgjithshëm mbi ciklet

1. Puna mësimore - edukative qëndron në themel të të gjithë veprimtarisë së shkollës, brenda dhe jashtë saj.
2. Individualiteti dhe dinjiteti njerëzor duhet të respektohet.
3. Individui mbrohet nga dhuna fizike e psikologjike, diskriminimi e veçimi.
4. Në kopësht e në shkollë janë të ndaluara ndëshkimet fizike apo trajtimet poshtëruese e denigruese të fëmijëve.
5. Forma e programeve mësimore të ofruara nga institucionet arsimore parauniversitare të NG Albania janë sipas kërkesave të ligjit dhe licensave përkatëse.
6. Programet mësimore organizohen në cikle konsektive: arsimit parashkollor, arsimit bazë (arsimi fillor dhe arsimit i mesëm i ulët) dhe arsimit mesëm i lartë. Shkolla Nehemia mund të ofrojë programe mësimore të çdo cikli shkollimi të lartpërmendur. Shkolla Amaro Tan mund të ofrojë programe mësimore deri në ciklin e mesëm të ulët. Shkolla Amaro Tan ofron lëndë shtesë sipas licencës përkatëse.
7. Pjesë përbërëse e gjithë punës mësimore - edukative dhe në shërbim të saj janë edhe detyrat me karakter praktik dhe krijues, ekskursionet, testimet, diskutimet dhe konkurset mësimore dhe veprimtaritë e tjera ndihmëse, që në tërësi ndihmojnë në zhvillimin e individit dhe në mendimin e lirë e të pavarur të nxënësve.
8. Forma të punës mësimore janë: mësimdhënia, leksioni, referimi i mësuesit, provimet periodike, ushtrimet, punët laboratorike, detyrat e shtëpisë, punët e pavarura, esetë, provimet shtetërore (të lirimt dhe të maturës), mësimet treguese, konsultimet në grup e ato individuale, modulet, projektet kurrikulare dhe ndërkurrikulare.

Neni 2

Baza ligjore

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 57
2. Ligji 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë
3. Korniza Kurrikulare e arsimit parauniversitar
4. Standartet e të nxënësve
5. Programet lëndore
6. Urdhërat dhe udhëzimet e nxjerra nga ministria përgjegjëse për arsimin

Neni 3

Ndryshimet në programet shkollore

1. Ndryshimet në programet shkollore janë gjithmonë subjekt i miratimit nga autoriteti përkatës. Ndryshimet mund të propozohen nga Drejtoria dhe duhet të aprovohen nga Drejtori Ekzekutiv dhe Bordi Mbikëqyrës përpara zbatimit të tyre. Ndryshimet në programe mund të zbatohen vetëm në fillim të vitit pasues shkollor, me përjashtim të rasteve kur lejohet ndryshe nga autoriteti përkatës.

Neni 4

Viti shkollor

1. Viti shkollor në Shkollën Nehemia dhe Shkollën Amaro Tan zakonisht fillon të hënën e parë të shtatorit.
2. Dispozitat normative dhe vendimet e ministrisë përkatëse të arsimit specifikojnë detaje të mëtejshme mbi organizimin e studimeve në semestra.
3. Nxënësi mund të kalojë nga një vit shkollor në tjetrin pasi të ketë përmbushur detyrimet shkollore të parashikuara në programin e klasës dhe në përputhje me dispozitat normative dhe kontratën shkollore.

Neni 5

Tarifat e shkollimit dhe tarifa të tjera

1. Tarifa e shkollimit ndryshon sipas ciklit shkollor.
2. Pagesat dhe tarifat propozohen nga Drejtori dhe duhet të aprovohen nga Drejtori Ekzekutiv.
3. Informacioni mbi pagesat dhe tarifat vihet në dispozicion të nxënësit dhe prindit, përpara se ky i fundit të nënshkruajë kontratën për vitin shkollor.

Neni 6

Cikli parashkollor

1. Cikli parashkollor ose Kopshti, referuar me kodin 0 sipas Klasifikimit Ndërkombëtar Standard të Arsimit, synon të ofrojë zhvillimin e personalitetit të çdo fëmije, ushtrimin e rregullave themelore të sjelljes e të higjienës, kultivimin e vlerave si dhe përgatitjen për arsimin fillor.
2. Kopshti Nehemia është i organizuar në katër grupe sipas moshave. Kopshti Amaro Tan është i organizuar në dy grupe me moshë të përzjera.
3. Fëmija qendron në kopsht deri në moshën 6 vjeç. Fëmija 6 vjeç ka të drejtë të qendrojë në kopsht deri një ditë para fillimit të klasës së parë.
4. Kopshti funksionon gjatë gjithë vitit kalendarik.
5. Kurrikula në arsimin parashkollor mbështetet në këto dokumente: Ligji i Arsimit Parauniversitar, Korniza Kurrikulare e arsimit parashkollor, standartet e zhvillimit dhe të të nxënësve për fëmijët 3-6 vjeç dhe programet e arsimit parashkollor për çdo grup moshë.
6. Kopshti e realizon veprimtarinë e tij sipas udhëzimit për vitin shkollor që nxjerr ministria.
7. Gjatë pushimeve, veprimtaria e kopshtit planifikohet nga mësuesit në bashkëpunim me prindërit e fëmijëve dhe miratohet nga drejtori i institucionit arsimor.
8. Mësuesi i arsimit parashkollor harton planin mësimor vjetor të veprimtarive të grupit, në bashkëpunim me prindërit e fëmijëve, me qëllim që veprimtaritë që zhvillohen në kopsht dhe në shtëpi, të plotësojnë dhe të përforcojnë njëra-tjetrën.
9. Plani mësimor vjetor i grupit miratohet nga drejtori i institucionit arsimor
10. Në arsimin parashkollor, vlerësimi i fëmijës realizohet në përputhje me kornizën e vlerësimit.

Neni 7

Pranimi në ciklin parashkollor

1. Pranimi në kopsht i fëmijëve parashkollorë të rinj bëhet pas një testi të sjelljes shoqërore dhe aftësisë kuptuese të fëmijës dhe në vijim sipas vendimit të drejtorit të institucionit arsimor.
2. Fëmija që në fillim të vitit shkollor mbush moshën 3, 4 ose 5 vjeç, ka të drejtën të regjistrohet përkatësisht në grupin e parë, të dytë, të tretë dhe të katërt (klasa përgatitore për klasën e parë.)
3. Përpara pranimit në kopsht fëmija duhet të jetë i përgatitur nga prindi për të qenë në gjendje të përdorë vetë servisin e ngrënies. Fëmija duhet të jetë në gjendje të përdorë vetë tualetin.
4. Regjistrimi i fëmijëve në kopsht bëhet me dokumentat që vijojnë:
 - a. Certifikata e lindjes së fëmijës;
 - b. Vërtetimi i vaksinave nga qendra shëndetësore;
 - c. Formulari i regjistrimit të nënshkruar nga prindi ose përfaqësuesi ligjor.
5. Drejtorja e institucionit arsimor mund të përcaktojë kritere dhe procedura shtesë pranimi, të cilat u bëhen të ditura prindërve përpara pranimit.

Neni 8

Kurrikula e arsimit bazë (arsimi fillor dhe arsimi i mesëm i ulët)

1. Kurrikula në arsimin bazë mbështetet në këto dokumente: Ligji i Arsimit Parauniversitar, Korniza Kurrikulare e arsimit parauniversitar, standartet e të nxënësve, programet lëndore, urdhrat dhe udhëzimet e nxjerra nga ministria përgjegjëse për arsimin.
2. Kurrikula e arsimit bazë është e organizuar në kurrikul bërthamë dhe kurrikul me zgjedhje.
3. Kurrikula bërthamë është e detyruar dhe e përbashkët për të gjithë nxënësit.

4. Kurrikula me zgjedhje është pjesë e kurrikulës së përgjithshme, zgjidhet nga shkolla dhe zhvillohet brenda kohës së planifikuar në planin mësimor, në përputhje me interesat, me nevojat e nxënësve dhe me mundësitë e shkollës.

Neni 9 **Arsimi fillor**

1. Arsimi fillor përfshin klasat I-V referuar me kodin 1 sipas Klasifikimit Ndërkombëtar Standard të Arsimit.
2. Arsimi fillor synon zhvillimin shoqëror, intelektual dhe fizik të çdo nxënësi, zotërimin e rregullave të sjelljes dhe kultivimin e vlerave, përkujdesjen për shëndetin si dhe përgatitjen e mjaftueshme për vazhdimin e arsimit të mesëm të lartë.

Neni 10 **Pranimi në arsimin fillor**

1. Pranimi **në klasën e parë** bëhet përmes një testi pranimi përzgjedhës të organizuar nga drejtoria e institucionit arsimor dhe në prani të një psikologu të trajtuar për këtë test inteligjence.
2. Ky test, (konkurs) zhvillohet në muajin gusht.
3. Regjistrimi në klasën e parë dhe në klasat e II-V bëhet **në dy javët e fundit të muajit qershor**, me përjashtim të rastit kur fëmija ndryshon vendbanimin deri në ditët e fillimit të shkollës.
4. Regjistrimi i fëmijës **në klasën e parë dhe në klasat II-V** bëhet me dokumentat që vijnë:
 - a. Certifikata e lindjes së fëmijës;
 - b. Vërtetimi i vaksinave nga qendra shëndetësore;
 - c. Formulari i regjistrimit të nënshkruar nga prindi ose përfaqësuesi ligjor
 - d. Dëftesa e klasës paraardhëse (për nxënësit që duan të regjistrohen në klasat II-V)
5. Nxënësi që pranohet në klase të parë duhet të ketë mbushur 6 vjeç dhe të shpallet fitues pas testit të pranimit. Fëmijët që vijnë nga kopshti Nehemia kanë prioritet.
6. Shkolla Amaro Tan nuk ka testim pranimi për fëmijët në klasën e parë, por iu jep prioritet fëmijëve që vijnë nga kopshti Amaro Tan.
7. Nxënësve të rinj në klasat II-V iu këshillohet një javë prove në klasën përkatëse, përpara se të ftohen në procesin e përzgjedhjes.
8. Nxënësit e rinj në klasat e ndërmjetme përzgjidhen në bazë të mesatares dhe me një testim dhe interviste pranuese me kandidatin dhe prindin.
9. Testimi zhvillohet në lëndët që shkolla i konsideron bazë dhe të rëndësishme për formimin e nxënësve.
10. Komisioni i Pranimit organizon të gjithë procesin dhe vendos për fituesit.

Neni 11 **Arsimi i mesëm i ulët**

1. Arsimi i mesëm i ulët përfshin klasat VI-IX me kodin 2 sipas Klasifikimit Ndërkombëtar Standard të Arsimit.
2. Arsimi i mesëm i ulët synon zhvillimin shoqëror, intelektual dhe fizik të çdo nxënësi, zotërimin e rregullave të sjelljes dhe kultivimin e vlerave, përkujdesjen për shëndetin si dhe përgatitjen e mjaftueshme për vazhdimin e arsimit të mesëm të lartë.
3. Pas përfundimit me sukses të arsimit bazë dhe provimeve të lirimit nxënësit i jepet dëftesa e arsimit bazë në përputhje me Ligjin në fuqi.

Neni 12 **Pranimi në arsimin e mesëm të ulët**

1. Nxënësit që përfundojnë klasën e pestë të ciklit fillor në shkollën Nehemia dhe Shkollën Amaro Tan kanë të drejtën të vijnë **pa konkurs** ciklin e mesëm të ulët të shkollës përkatëse.

2. Shkolla Nehemia dhe Shkolla Amaro Tan iu jep mundësi për pranim edhe nxënësve të tjerë të rinj në klasat e ndërmjetme të arsimit bazë.
3. Nxënësve të rinj në klasat e ndërmjetme iu këshillohet një javë prove në klasën përkatëse, përpara se të ftohen në procesin e përzgjedhjes.
4. Nxënësit e rinj në klasat e ndërmjetme përzgjidhen në bazë të mesatares dhe me një testim dhe interviste pranuese me kandidatin dhe prindin.
5. Testimi zhvillohet në lëndët që shkolla i quan të rëndësishme dhe bazë për formimin e nxënësve.
6. Komisioni i Pranimit organizon të gjithë procesin dhe vendos për fituesit.
7. Regjistrimi në arsimin e mesëm të ulët bëhet **në dy javët e fundit të muajit qershor**, me përjashtim të rastit kur fëmija ndryshon vendbanimin deri në ditët e fillimit të shkollës.
8. Regjistrimi bëhet me dokumentat që vijojnë:
 - a. Certifikata e lindjes së fëmijës;
 - b. Dëftesa e klasës paraardhëse
 - c. Vërtetimi i vaksinave nga qendra shëndetësore;
 - d. Formulari i regjistrimit të nënshkruar nga prindi ose përfaqësuesi ligjor

Neni 13

Kurrikula e arsimit të mesëm të lartë

1. Kurrikula e arsimit të mesëm të lartë bazohet në Ligjin e Arsimit Parauniversitar dhe në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.
2. Zbatimi i kurrikulës në arsimin të mesëm të lartë mbështetet në dokumentet kurrikulare dhe në udhëzimet e ministrit.
3. Kurrikula e gjimnazit është e organizuar në kurrikulët bërthamë, kurrikul me zgjedhje dhe kurrikul në bazë shkolle.
4. Kurrikula bërthamë është e detyruar dhe e përbashkët për të gjithë nxënësit.
5. Kurrikula me zgjedhje fokusohet në zgjedhjen e lëndëve/moduleve që nuk zhvillohen në kurrikulën bërthamë.
6. Kurrikula në bazë shkolle nuk është e detyruar për nxënësin: ajo i mundëson nxënësit të zhvillojë aftësitë nëpërmjet moduleve kurrikulare, projekteve ndërkurrikulare apo veprimtarive të tjera shkollore.
7. Shkolla ka detyrimin t'i sigurojë secilit nxënësi:
 - a) kurrikulën bërthamë të plotë,
 - b) numrin e orëve mësimore të kurrikulës me zgjedhje
 - c) numrin e orëve për shërbimin komunitar.

Neni 14

Arsimi i mesëm i lartë

1. Arsimi i mesëm i lartë ofrohet vetëm nga Gjimnazi Nehemia. Ai përbëhet nga klasat X-XII referuar me kodin 3 sipas Klasifikimit Ndërkombëtar Standard të Arsimit.
2. Arsimi i mesëm i lartë synon zhvillimin e mëtejshëm të kompetencave të fituara nga arsimi bazë, konsolidimin e individualitetit të çdo nxënësi dhe tërësinë e vlerave dhe qëndrimeve, zgjerimin dhe thellimin në fusha të caktuara të dijes dhe përgatitjen për arsimin tretësor.
3. Pas përfundimit me sukses të gjimnazit dhe provimeve të pjekurisë, nxënësit i jepet diploma e maturës shtetërore në përputhje me Ligjin në fuqi.

Neni 15

Procedurat për kurrikulën me zgjedhje në arsimin e mesëm të lartë

1. Drejtoria i institucionit arsimor, mësuesit kujdestarë dhe ekipet lëndore:
 - a) Informojnë nxënësit për listën e lëndëve/moduleve me zgjedhje që ofron shkolla për secilën klasë:

- b) Sigurojnë formularët përkatës për t'u plotësuar nga nxënësit.
2. Drejtori i institucionit arsimor miraton, brenda muajit gusht, planin e kurrikulës me zgjedhje për çdo lëndë/modul me zgjedhje dhe përcakton mësuesit që do t'i zhvillojnë.
3. Procedurat për zbatimin e kurrikulës me zgjedhje përcaktohen me udhëzim të ministrit.
4. Nuk lejohet që nxënësi ta ndërrojë lëndën me zgjedhje gjatë vitit shkollor.

Neni 16

Pranimi në arsimin e mesëm të lartë

1. Nxënësit që përfundojnë klasën e nëntë të arsimit të mesëm të ulët në shkollën Nehemia kanë të drejtën të vijojnë **pa konkurs** arsimin e mesëm të lartë (Gjimnazin) Nehemia.
2. Nxënësit që përfundojnë klasën e nëntë të arsimit të mesëm të ulët në shkollën Amaro Tan me mesatare të lartë kanë prioritet për të vijuar Gjimnazin Nehemia. Megjithatë, ata i nënshtrohen testit të pranimit dhe intervistës ashtu si nxënësit që regjistrohen për herë të parë në Gjimnazin Nehemia.
3. **Pranimi për herë të parë në klasën e X-të, apo edhe në klasat XI-XII** të Shkollës Nehemia bëhet përmes një testi përzgjedhës dhe një interviste me kandidatin dhe prindin.
4. Testimi zhvillohet në lëndët që shkolla i quan të rëndësishme dhe bazë për formimin e nxënësve.
5. Regjistrimi në arsimin e mesëm të lartë bëhet **në dy javët e para të muajit korrik**, me përjashtim të rastit kur fëmija ndryshon vendbanimin deri në ditët e fillimit të shkollës.
6. Regjistrimi bëhet me dokumentat që vijojnë:
 - a. Certifikata e lindjes së fëmijës;
 - b. Dëftesa e klasës së nëntë ose e klasës paraardhëse
 - c. Vërtetimi i vaksinave nga qendra shëndetësore;
 - d. Formulari i regjistrimit të nënshkruar nga prindi ose përfaqësuesi ligjor
7. Komisioni i Pranimit organizon të gjithë procesin dhe vendos për fituesit.

Neni 17

Funksioni dhe detyrat kryesore të Komisionit të Pranimit

1. Komisioni i Pranimit ngrihet në nivel cikli.
2. Përgjegjësia kryesore e këtij komisioni është të administrojë një proces pranimi mirë-funksionues, transparent, profesional dhe në kohë për aplikantët që dëshirojnë të mësojnë në shkollën Nehemia dhe shkollën Amaro Tan.
3. Detyrat kryesore të këtij komisioni përfshijnë janë:
 - a) Formulon dhe i rekomandon Drejtorisë politikat për pranimin e nxënësve në shkollë.
 - b) Pranon nxënësit në shkollë nëpërmjet proceseve të bazuara në politikat e aprovuara. Politika të tilla lidhen me caktimin e:
 - i) Kriteve dhe standardeve për vlerësimin e aplikantëve
 - ii) Procedurave për aplikim
 - iii) Procedurave për shqyrtimin e aplikimeve
 - iv) Procedurave për pranimin e aplikantëve
 - c) Formulon dhe rekomandon politikat në lidhje me rekrutimin e nxënësve.
 - d) Mban proces-verbale, të cilat lejojnë vlerësim të vazhdueshëm të politikave dhe proceseve në lidhje me pranimet.
 - e) Zhvillon mënyra për lehtësimin e kuptimit të politikave dhe procedurave të pranimit midis personelit të IA-së dhe kandidatëve të interesuar që dëshirojnë të mësojnë në të.
4. Kjo rregullore dhe nënregulloret e brendshme mund të përcaktojnë detyra shtesë për Komisionin e Pranimit.

Neni 18

Përbërja dhe mbledhjet e Komisionit të Pranimit

1. Komisioni i Pranimit përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm:

- a) Drejtori i IA-së
 - b) Nëndrejtori i ciklit ku bëhen pranimet,
 - c) Psikolog dhe/ose mësues, në varësi të ciklit për të cilin është duke u zhvilluar pranimi.
2. Drejtori i IA-së dhe nëndrejtori përkatës janë anëtarë ex-officio të komisionit. Në mungesë të nëndrejtorit, Drejtori i IA-së mund të emërojë një tjetër person si anëtar të komisionit për të kryer zhvillimin e pranimeve. Psikologu/ mësuesi zgjidhet nga Drejtori i IA-së. Mandati i anëtarëve jo-ex-officio është për një periudhë dy vjeçare me të drejtë riemërimi.
 3. Takimet e Komisionit thirren dhe drejtohen nga Drejtori i IA-së. Komisioni mblidhet rregullisht, dhe në çdo kohë të nevojshme për qëllime pranimi.
 4. Vendimet e Komisionit të Pranimi zakonisht merren në mënyrë unanime. Kur kjo nuk është e mundur dhe për të siguruar një ecuri normale të funksioneve kryesore të akademisë, vendimet merren me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm në takim. Të gjithë anëtarët e Komisionit duhet të jenë të pranishëm në takim që vendimet të jenë të vlefshme.
 5. Procesverbali i takimit përbën provën bazë për vendimet e marra. Procesverbali nënshkruhet nga Drejtori, i cili thërret dhe drejton mbledhjen.

Neni 19

Lëshimi i diplomave, suplementit dhe certifikatave të tjera

1. Pas përfundimit me sukses të një klase drejtori i institucionit arsimor lëshon një dokument zyrtar, i cili vërteton klasën e përfunduar.
2. Pas përfundimit të arsimit bazë, drejtori i institucionit arsimor lëshon dëftesën e arsimit bazë, për nxënësit kalues në provimet kombëtare dhe që kanë shlyer detyrimet ndaj shkollës.
3. Pas përfundimit të arsimit të mesëm të lartë, nxënësit kalues në provimet e matures Shtetërore u lëshohet Diploma e Maturës Shtetërore. Ajo lëshohet nga Agjencia Kombëtare e Provimeve. Drejtori i institucionit arsimor lëshon certifikatën e gjimnazit, e cila shoqëron Diplomën e Maturës Shtetërore.
4. Diplomimi i maturantëve bëhet me një ceremoni formale dhe festive. Nehemiah Gateway Albania i'u jep të gjithë të diplomuarve një unazë me simbolet e organizatës.

Neni 20

Transferimi i nxënësve

1. Shkolla Nehemia dhe Shkolla Amaro Tan i lejon nxënësit të transferojnë studimet e tyre, ndërmjet dy shkollave ose nga institucione të tjera të arsimit parauniversitar drejt shkollës Nehemia dhe Shkollës Amaro Tan dhe anasjelltas.
2. Transferimi i nxënësit si rregull bëhet pas përfundimit të vitit shkollor ose pas përfundimit të semestrit të parë me kërkesën me shkrim të prindit.
3. Transferimi i nxënësve bëhet në përputhje me ligjin në fuqi dhe këtë rregullore. Lëvizjet e nxënësve pasqyrohen në amzë.

Neni 21

Veprimtarite plotësuese dhe jashtë kurrikulare

1. Institucionet arsimore të Nehemiah Gateway Albania ofrojnë veprimtari plotësuese të cilat planifikohen nga drejtorja në bashkëpunim me këshillin e mësuesve. Veprimtaritë plotësuese dhe jashtë kurrikulare nuk çenojnë orët e mësimi.
2. Veprimtari të tilla janë: veprimtaritë kulturore-aristitike, sportive, letrare, shkencore, mjedisore, ekskursionet, vizita, kampe tematike dhe konkurse e olimpiada që thellojnë kurrikulën.
3. Shkolla Nehemia ofron programin Royal Rangers dhe Përgjegjësia Sociale në arsimin bazë si dhe Programin Business@school dhe Praktikën verore në arsimin e mesëm të lartë.
4. Pas përfundimit me sukses të programeve jashtë kurrikulare të miratuara nga shkolla nxënësit i lëshohet një certifikatë pjesëmarrjeje.

Neni 22

Oraret e mësimit

1. Veprimtaria në institucionet arsimore është 5 (pesë) ditë në javë, nga e hëna deri të premten.
2. Ora e mësimit (akademike) është 45 min., të cilat ofrohen edhe si orë dyshe (45min +45min) në lëndë të caktuara. Organizimi i orarit të shkollës për orë të njëpasnjëshme vendoset nga drejtori i shkollës dhe këshilli i mësuesve.
3. Ora e mësimit është e pacënueshme, me përjashtim të rasteve të veçanta, kur cenohet shëndeti dhe siguria e fizike e nxënësve.
4. Dita mësimore duhet të jetë jo më shumë se 7 orë mësimore dhe përfundon sipas cikleve: fillor, i mesëm i ulët dhe i mesëm i lartë.
5. Orari mësimor për çdo vit dhe klasë mësimore hartohet duke ndjekur kriteret pedagogjike, ngarkesën e nevojshme kohore dhe lëndore. Ai duhet të bëhet publik dhe të afishohet në ambjentet e përbashkëta të nxënësve. Respektimi i orarit dhe i auditorit është i detyrueshëm për të gjithë.
6. Oraret e mësimit në shkollën Nehemia orientohen sipas nevojave të shkollës dhe aktiviteteve në kampusin e NG Albania. Ato janë si më poshtë:
 - Arsimi Fillor (EMS) (Klasat I-V): mësimi fillon më 8:20 dhe mbaron më 13:40
Largimi: 15:00
 - Arsimi i Mesëm i Ulët (MSC) (Klasat VI-IX): mësimi fillon më 7:55 dhe mbaron më 14:05
Largimi 15:30
 - Arsimi i Mesëm i Lartë (HSC) (Klasat X-XII): mësimi fillon më 7:30 dhe mbaron më 13:40
Largimi: 13:50
7. Orari mësimor për shkollën Amaro Tan është
 - Arsimi Fillor (EMS) (Klasat I-V): mësimi fillon më 9:00 dhe mbaron më 13:30.
Largimi më 15:50
 - Arsimi i Mesëm i Ulët (MSC) (Klasat VI-IX): mësimi fillon më 8:50 dhe mbaron më 13:30.
Largimi më 15:50

Neni 23

Veprimtaritë plotësuese dhe ato jashtëshkollore

1. Veprimtaritë plotësuese dhe ato jashtëshkollore planifikohen nga drejtorja e institucionit arsimor në bashkëpunim me këshillin e mësuesve, bazuar në udhëzimin e vitit shkollor, si dhe me miratim të Zyrës Vendore Arsimore.
2. Veprimtaritë plotësuese dhe ato jashtëshkollore përfshijnë:
 - a) Veprimtari social-kulturore, artistike, sportive, letrare, shkencore, mjedisore
 - b) Ekskursione, vizita dhe konkurse që plotesojnë e thellojnë kurrikulën
 - c) Festime të ditëve të shënuara.
3. Veprimtaritë plotësuese dhe ato jashtëshkollore që zhvillohen në nivel institucioni arsimor pasqyrohen në një dokument ku shënohet synimi i veprimtarisë dhe pjesëmarrja dhe përshkruhet përmbledhtas ecuria e saj.
4. Veprimtaritë plotësuese, ato jashtëshkollore dhe veprimtari të tjera, si olimpiadat, zhvillohen pa cenuar orët mësimore të parashikuara në planin mësimor.
5. Pjesëmarrja e nxënësve në këto veprimtari është vullnetare dhe gjithëpërfshirëse.
6. Veprimtaritë e nxënësve përmbushin kushtet e sigurisë, të ruajtjes së jetës dhe të shëndetit të tyre.

Neni 24

Publikimi i rregullores

1. Kjo Rregullore dhe çdo ndryshim i saj duhet të publikohet dhe të jenë të aksesueshëm elektronikisht dhe në formë të shtypur veçanërisht për personelin e shkollës dhe nxënësit.
2. Drejtorja është përgjegjëse për të garantuar publikimin dhe aksesimin e rregullores.

Neni 25
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore per arsimin parauniversitar tek Nehemiah Gateway Albania dhe ndryshimet në të hyjnë në fuqi ditën që miratohet.

Lëshuar nga:

Elona Rira

Drejtoresh e Shkollës Nehemia

Buçimas, më _____

Miratuar nga:

Herolinda Shkullaku

Drejtor Ekzekutiv N.G.Albania

Buçimas, më _____